

# PARAJA PUBLIKE APO KONKURRENCA?

PRISHTINË,  
DHJETOR 2015



TRANSPARENCA DHE  
KUNDËRKORRUPSIONI





# **TË RUHET PARAJA PUBLIKE APO KONKURRENCA?**

**MONITORIMI I PROKURIMIT  
PUBLIK NË AGJENCINË  
QËNDRORE TË PROKURIMIT**





# **PARAJA PUBLIKE APO KONKURRENCA?**

PRISHTINË,  
DHJETOR 2015

# **PROKURIM PUBLIK**

**DILEMA: TË RUHET  
PARAJA PUBLIKE APO  
KONKURRENCA?**

COPYRIGHT © 2015. Kosova Democratic Institute (KDI).

Instituti Demokratik i Kosovës i ka të gjitha të drejtat të rezervuara dhe asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet ose të transmetohen në çfarëdo forme, mekanike apo elektronike, përfshirë fotokopjimin ose çdo sistem tjetër të ruajtjes dhe nxjerrjes së materialeve, pa lejen me shkrim të botuesit. Publikimi mund të riprodhohet ose të transmetohet vetëm nëse përdoret për qëllime jokomerciale. Kurdo dhe kushdo që përdor citate a materiale të ndryshme të këtij botimi, është i obliguar ta bëjë të qartë burimin nga do t'i ketë marrë ato citate ose materialeve që përdoren.

Për çdo vlerësim, vërejtje, kritikë apo sugjerim, luteni të na kontaktoni përmes mundësive të ofruara më poshtë:

Adresa: Rr. Bajram Kelmendi, Nr. 45,

10000, Prishtinë, Kosovë.

Tel.: +381 (0)38 248 038

E-mail: [info@kdi-kosova.org](mailto:info@kdi-kosova.org)

Web: [www.kdi-kosova.org](http://www.kdi-kosova.org)

Publikimi i këtij raporti është bërë i mundur me përkrahjen e Ambasadës Britanike. Opinionet, të gjeturat dhe rekomandimet e shprehura në këtë raport janë përgjegjësi e KDI-së dhe jo domosdoshmërisht paraqesin qëndrimet e donatorit.

# PËRMBAJTJA

<b>LISTA E SHKURTESAVE.....</b>	<b>9</b>
<b>DEFINICIONE TË TERMEVE KRYESORE .....</b>	<b>10</b>
<b>HYRJE .....</b>	<b>12</b>
<b>PËRZGJEDHJA .....</b>	<b>14</b>
<b>METODOLOGJIA.....</b>	<b>15</b>
<b>TRANSPARENCA .....</b>	<b>16</b>
<b>PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....</b>	<b>17</b>
<b>ANALIZA E KONTRATËS .....</b>	<b>18</b>
<b>VLERËSIMI I NEVOJAVE DHE PLANIFIKIMI.....</b>	<b>18</b>
<b>PËRGATITJA E SPECIFIKACIONEVE TEKNIKE DHE DOSJES SË TENDERIT .....</b>	<b>22</b>
<b>VLERËSIMI I OFERTAVE .....</b>	<b>26</b>
<b>ZBATIMI I KONTRATËS, MONITORIMI I PERFORMANCËS DHE PAGESAVE .....</b>	<b>27</b>
<b>KONKLUZION .....</b>	<b>33</b>
<b>REKOMANDIME .....</b>	<b>34</b>
<b>REKOMANDIMET PËR INSTITUCIONET RREGULLATIVE .....</b>	<b>34</b>
<b>REKOMANDIMET PËR INSTITUCIONIN KONTRAKTUES .....</b>	<b>34</b>



# LISTA E SHKURTESAVE

AK	Autoritet Kontraktues
AQP	Agjencia Qendrore e Prokurimit
ATK	Administrata Tatimore e Kosovës
BE	Bashkimi Evropian
BPV	Bruto Produkti Vendor
DT	Dosja e Tenderit
EU	European Union
KDI	Instituti Demokratik i Kosovës
KRPP	Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik
LPP	Ligji i Prokurimit Publik
MF	Ministria e Financave
MTI	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
NVM	Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme
OE	Operator Ekonomik
OSHP	Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik
TI	Transparency International
UA	Udhëzues Administrativ
ZAP	ZAP Zyra e Auditorit të Përgjithshëm
ZP	Zyrtar i Prokurimit
ZK	Zyra e Kryeministrit



# DEFINICIONE TË TERMEVE KRYESORE

TERMI	DEFINICIONI	SHEMBULL
Akciza për litër	Tatim, i një lloji të veçantë, që aplikohet mbi prodhimet e vendit dhe mbi produktet e importuara	Taksë e veçantë që aplikohet për çdo litër të derivatit të importuar.
Artikuj të përdorimit të përbashkët	Prodhimi ose shërbimi i kërkuar nga një ose më shumë autoritete kontraktuese, për të cilat mund të arrihet përdorimi më efikas dhe me kosto ekonomike e fondeve publike me anë të zhvillimit të prokurimit qendror, të përbashkët ose të konsoliduar.	Nafta, letra, ushqimet, riparimi i automjeteve.
Berza mesatare mujore	Kalkulimi i mesatares të gjitha çmimeve mujore të berzës.	
Çmim jo normalisht i ulët	Çmimi i tenderit kur kosto ekonomike e procesit të prodhimitarisë dhe të shërbimeve të ofruara është më e lartë se ajo e ofruar, i cili rrezikon të mbetet i pazbatueshëm.	Kur çmimi artikullit ofrohet me çmim më të ulët sesa kostoja e prodhimit. Për shembull dritare me kornizë me pesë euro
Çmimi për faturim	Çmimi final duke i përfshirë të gjitha taksat dhe komponentët shtesë, të cilin duhet ta paguajë konsumatori	
Dosje e Tenderit	Dokument në të cilin përshkruhen kushtet dhe kriteret për shpërblim me kontratë	
Furnizues / Furnitor	Operatori Ekonomik që është kontraktuar të ofroj një shërbim apo produkt	
Kursi mesatar mujor	Kalkulimi i mesatares të gjitha kurseve valutore mujore.	
Llot	Tender i ndarë në pjesë	Tenderimi i 30 lloje të barnave esenciale, në një procedurë të vetme tenderuese



|||||

TERMI	DEFINICIONI	SHEMBULL
Maune	Mjet për transportimin e naftës	
Njoftim për dhënie të kontratës	Njoftim përmes të cilit shpallet fituesi i një procedure tenderuese, në të cilën përfshihet çmimi dhe kontaktet e kompanisë	
Njoftim për Kontratë	Njoftim për shpalljen e tenderit në Ueb Faqen e KRPP	
Operator Ekonomik	Furnizues, ofrues i shërbimeve ose kontraktues i punëve	
Paramasa	Parallogaritja e nevojave për artikuj të caktuar ose punë, në tenderët me çmime për njësi	
PLATTS	Kompani për konsulta për çmimin e karburanteve dhe energjisë	Çmimi i naftës në mesataren mujore
Premium	Premium nënkupton marzhën e fitimeve të kompanisë për çdo litër naftë	0.0001 euro për çdo litër naftë që i shitet institucionit
Premiumi i rafinerisë	Fitimi i rafinerisë në shitjen e naftës, zakonisht për Ton	
Raport i Vlerësimit	Raport të cilin e përgatitë Komisioni për vlerësimin e ofertave, i cili i dorëzohet zyrtarit kryesor të prokurimit, në formë të rekomandimit	
Siguria (garancia) e ekzekutimit	Dokument me të cilën kompania garanton përfundimin e suksesshëm të kontratës	Depozita bankare, apo siguria e tenderit përmes kompanive të sigurimit

|||||

# HYRJJE

Kontratat e prokurimit publik përbëjnë një pjesë të madhe të buxhetit të Produktit të Brendshëm Bruto (PBB) dhe të shpenzimeve publike të çdo vendi, dhe si të tilla paraqesin një pikë shumë të ndjeshme dhe të ekspozuar ndaj manipulimeve dhe keq menaxhimeve të mundshme. Kontratat publike shfrytëzohet për blerjet më të ndryshme, duke filluar nga një laps i thjeshtë apo uji të pijshëm, e deri te ndërtimi i autostradave, apo kontraktime të shërbimeve të ndjeshme shtetërore, dhe si të tilla gjenerojnë një qarkullim të madh të parasë, dhe nëse janë të menaxhuara mirë, janë një indikator kyç në zhvillim e sektorit të biznesit. Një menaxhim i dobët i prokurimit publik parandalon zhvillimin e mirëfillt të konkurrencës së tregut, duke krijuar mundësi favorizuese për operator ekonomik të caktuar, dhe humb “vlerën për paranë” duke paguar më shtrenjtë për shërbimet dhe mallrat se edhe në tregun me pakicë, respektivisht duke rritur shpenzimet publike dhe ndikuar negativisht në burimet, apo investimet e kthyer nga Qeveria për tatimpaguesit. Deri më sot kemi shumë e shumë raste ku produkte të natyrës më të thjeshtë si uji, letra për printim, nafta, barnat nga lista esenciale, të cilat shteti ka paguar shumë më shtrenjtë se në tregun me pakicë. Një nga qëllimet kryesore të hyrjes në kontrata afatgjate është sigurimi i kushteve më të favorshme për palët në marrëveshje si nga aspekti i çmimit, po ashtu edhe nga aspekti i garancisë dhe menaxhimit.

Një nga metodat efektive të parandalimit apo adresimin e gjetjeve të praktikave korruptive është monitorimi i kontratave publike.

“Monitorimi efektiv luan një rol të rëndësishëm në parandalimin e korrupsionit dhe ndihmon për tu siguruar se sjellja e korruptuar është ekspozuar dhe është sanksionuar siç duhet”.<sup>1</sup>

Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), në kuadër të Programit të Transparencës dhe Kundër korrupsionit, respektivisht monitorimin e Prokurimit Publik, ka hulumtuar dhe publikuar shumë raporte mbi procedurat e përpilimit të specifikave teknike, procesit të tenderimit dhe vlerësimit të ofertave, dhënies së kontratave, menaxhimit të kontratave, ankesave dhe vendimeve të OSHP, të gjeturat në faza të ndryshme të prokurimit publik.

Prokurimi Publik në Kosovë ballafaqohet me probleme nga më të ndryshmet si dispozitat ligjore të pamjaftueshme,

AQP u krijua brenda Ministrisë së Financave me qëllim të aplikimit të ekspertizës profesionale, efektivitetit të kostos dhe çështjeve tjera legjitime, duke aplikuar aplikuar prokurimin e centralizuar për produktet e interes të përbashkët për të gjitha Institucionet Publike të Kosovës.

mungesa e trajnimeve adekuate, planifikimet e dobëta, mungesa e vullnetit të mirë dhe integritetit, mungesa e transparencës dhe llogaridhënies, etj. dhe konsiderohet si sektori më i korruptuar dhe keq menaxhuar brenda Institucioneve Publike të Kosovës.<sup>2</sup>

Me qëllim të përmirësimit të kësaj gjendje, Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik në bashkëpunim me projektin e financuar nga BE për “Përkrahje në Reformën e Prokurimit Publik në Kosovë” propozuan ndryshime në Ligjin e Prokurimit Publik, i cili hyri në fuqi me 05 tetor 2011, ku një nga ndryshimet kyçe ishte edhe shkrija e Agjencisë për Prokurim Publik në Agjencinë Qendrore të Prokurimit nën Ministrinë e Financave, ku qëllimi i kësaj Agjencie është prokurimi i mallrave apo artikujve të interesit të përbashkët. Sipas po të njëjtit ligj, Ministria e Financave duhet të përpilojë listën e artikujve të interesit të përbashkët, formulim ky i cili fatkeqësisht u ballafaqua nga një proces shumë i ngadalshëm i identifikimit dhe miratimit, dhe vetëm në shkurt të vitit 2015 u miratua Udhëzimi Administrativ (QRK) – Nr.02/2015 për implementimin e procedurave qendrore të prokurimit publik, ku u miratuan gjashtë (6) produkte të interesit të përbashkët si: derivatet, materialet për zyre, produktet higjienike, prokurimi i ushqimit, furnizimi me bileta, dhe furnizimi me goma.

Derivatet janë artikulli i interesit ku Institucionet Publike më së shpeshti kanë dështuar në sigurimin e një çmimi të arsyeshëm, dhe jo vetëm se është paguar në vlera të ndryshme, por edhe shumë herë është paguar mbi vlerën e tregut me pakicë, gjë që është dëshmuar edhe në raportin paraprak të

1 (Transparency-International, 2014)

2 BE: Raporti i Progresit 2015 Kosovo\*, 10/11/2015 Bruksel

|||||

KDI për tenderët kaotik të komunave, të publikuar në qershor 2015.

Me qëllim të fillimit të procedurave të prokurimit të përbashkët të karburanteve, AQP bëri njoftimin e parë për kontratë në janar 2014, i cili përfshinte vetëm gjashtë (6) autoritete kontraktuese që kishin shprehur vullnetin për të filluar një proces të tillë. Në shkurt 2014 është ri publikuar njoftimi me shtyrje të afatit për aplikim, si dhe përfshirjen e njëzet e shtatë (27) autoriteteve tjera kontraktuese në këtë aktivitet, duke e rritur numrin total në furnizim me karburante për tridhjetë e tri (33) Autoritete Kontraktuese. Ky tender u anulua me

26 mars 2014 në mungesë të ofertave të mjaftueshme të përgjegjshme, dhe u ri-tenderua në maj 2014 për tridhjetë e shtatë (37) Autoritete Kontraktuese, nën numrin e tenderit AK-T-14-002-1-1-1.

Qëllimi i këtij raporti është që të analizoj procedurat e tenderimit dhe dhënies së kontratës AQP-AK-14-002-1-1-1, monitorimin e zbatimit të kontratës, adresimn e gjetjeve e mundshme si dhe të ofrojë rekomandime për përmirësimin e politikave dhe praktikave aktuale në mënyrë që të përmirësohet Prokurimi Publik jo vetëm në AQP, por edhe institucionet tjera.

|||||



# PËRZGJEDHJA

Gjatë tri viteve të fundit, KDI ka avokuar që AQP të realizojë blerjet e interesit të përbashkët si një mundësi për të siguruar “vlerën për paranë” si dhe zvogëluar mundësitë e keq menaxhimit të kontratave.

Këto blerje të interesit të përbashkët, për të gjitha institucionet publike, paraqesin vlera të mëdha të zotimeve të fondeve. Një kursim sado i vogël në një artikull mund të përkthehet në një kursim shumë të madh të parasë publike, gjë që do të mundësonte investime shtesë kapitale apo të ndonjë lloji tjetër në kthimin e shërbimit për paranë tek tatim paguesit e Kosovës. Për shembull, kursimi i vetëm 0.01€ (1 Euro Cent) në sasinë prej 100,000 njësish jep kursimet prej 1,000€ të cilat do të mund të investoheshin diku tjetër. KDI ka zgjedhur të monitoroj dhe analizoj praktikatat e kontratës për furnizim me karburante për 37 Institucione Publike meqë është e para e llojit të prokurimit qendror të dhënë nga AQP, dhe interesi kyç është për të parë nëse ky lloj i kontratës paraqet një dobi për menaxhimin më të mirë të parasë publike në krahasim me kontratat ekzistuese.

Për përpilimin e këtij raporti, KDI ka analizuar mbi 100 dokumente dhe publikime, me mbi 2,000 faqe, ka pasur dhjetra takime dhe biseda telefonike, dhjetra komunikime përmes postës elektronike, ka parashtruar 12 kërkesa për qasje në dokumente zyrtare, etj.

Gjithashtu, meqë kjo është kontrata e parë e këtij lloji, KDI ka për qëllim që të vlerësoj praktikatat dhe procedurat e aplikuara, dhe të ofroj rekomandime praktike për AQP, Autoritetet Kontraktuese si dhe KRPP, se si do të mund të përmirësonim dhe përforconim këtë proces edhe më shumë.



# METODOLOGJIA

Metodologjia e hulumtimit në këtë raport tenton të matë zbatimin e legjislacionit të prokurimit publik, përmes ekzaminimit të kontratës së AQP për furnizim me derivate për 37 Autoritete Kontraktuese, të cilët janë analizuar në faza të ndryshme.

Për shkak të natyrës së kontratës së përzgjedhur, analiza trajton pesë (5) faza të prokurimit: vlerësimin e nevojave dhe planifikimit, përgatitjen e specifikacioneve teknike, vlerësimin e ofertave, zbatimin e kontratës dhe monitorimin e performancës, dhe fazën e auditimit dhe përmbylljes. Përpos tyre, kjo metodologji trajton nivelin e transparencës, proporcionalitetit, trajtimit të barabartë dhe mos-diskriminimin e Operatorëve Ekonomik (OE), si dhe ankesat e deponuara në Organin Shqyrtues të Prokurimit dhe vendimet e marra nga ky organ.

Kjo metodologji e hulumtimit dhe monitorimit në prokurimin publik është një nga praktikatat të cilat përdorën gjerësisht nga organizatat mbikëqyrëse dhe kryesisht nga degët e Transparency International, nëpër shtete të ndryshme.<sup>3</sup>

Përparësi kryesore e kësaj metodologjie është fakti se është gjithëpërfshirëse dhe nuk anashkalon asnjë nga fazat e prokurimit. Rëndësi të posaçme i është dhënë bashkëpunimit me operatorët ekonomik, përkatesisht bizneset të cilat janë në marrëdhënie kontraktuale me Autoritetin Qendror të Prokurimit.

Dokumentet të cilat janë përdorur gjatë ekzaminimit të tenderëve kanë qenë: raportet e vlerësimit të tenderëve, njoftimet për dhënie të kontratave, njoftimet për kontrata, dosjet e tenderit, ofertat e operatorëve ekonomik, kontratat publike, vendimet e OSHP-së, raportet e ekspertizës, ankesat e operatorëve. Monitorimi aktiv i projektit do të përmirësojë performancën e përgjithshme të institucioneve me buxhet/rrezik të lartë, si dhe përfshirja e akterëve të ndryshëm në këtë proces do të sjell përfitime për të gjitha palët e përfshira në proces. Pjesëmarrësit nga komuniteti i biznesit (të cilët nuk e kanë fituar tenderin), OJQ-të, gazetarët e mediave kërkimore, anëtarë të Komisionit për mbikëqyrjen e financave publike, Autoritetet Kontraktuese, Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, Zyra e Auditorit të Përgjithshëm do të kenë mundësinë të përfitojnë nga njohuritë e KDI të fituara ndër vite.


<sup>3</sup> Transparency International. (2006). Handbook for Curbing Corruption in Public Procurement. Berlin: Lisa Prevenslik, Kenneth Kostyo. Për më tepër: [http://www.transparency.org/whatwedo/pub/handbook\\_for\\_curbing\\_corruption\\_in\\_public\\_procurement](http://www.transparency.org/whatwedo/pub/handbook_for_curbing_corruption_in_public_procurement)



# TRANSPARENCA

Monitorimi i kësaj kontrate shërben gjithashtu edhe si një matës i transparencës së vet institucionit të AQP-së, si dhe Autoriteteve Kontraktuese të këtij shërbimi., KDI ka dërguar 12 kërkesa për qasje në dokumente publike, dhe ka pranuar 9 përgjigje. Institucionet që nuk i kanë kthyer përgjigjet janë Shërbimi Korrektues i Kosovës, Trainkos Sh.A. dhe Zyra e Kryeministrit.

Në vazhdim, KDI ka zhvilluar edhe një sërë intervistash, takimesh e bisedash telefonike me zyrtarët e AQP-së, Institucionet Publike, gazetarë hulumtues dhe Operatorë Ekonomik, me ç’rast pothuajse të gjithë kanë treguar vullnet të mirë dhe gatishmëri për përgjigje dhe bashkëpunim në procesin e monitorimit të kësaj kontrate, për ç’gjë KDI është falënderuese.





# PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Sektori i Prokurimit Publik vazhdon të jetë një nga sektorët më dinamik dhe më të përfolur sa i përket keq menaxhimit të parasë publike. Në këtë bazë janë angazhuar edhe shumë akterë të ndryshëm si nga nivelet kombëtare, po ashtu edhe nga ato ndërkombëtare, për të përmirësuar kualitetin e këtyre shërbimeve. Ndër projektet më aktive në përmirësimin e kapaciteteve dhe legjislaturës në Prokurimin Publik të Kosovës janë projekti i financuar nga BE për “Përkrahje në Reformën e Prokurimit Publik në Kosovë”, “Përmirësimi i Kapaciteteve Administrative në Fushën e Prokurimit Publik në Kosovë” i financuar nga BE, projekti i Bankës Botërore “Quick Gains Kosovo” dhe “Përmirësimi i implementimit të Prokurimit Publik në Kosovë”, Projekti i Reformës së Administratës Publike në Kosovë, dhe OECD/ SIGMA, projektet e ndryshme të mbështetura nga Ambasadat në Kosovë zakonisht të zbatuara përmes Shoqërisë Civile, gazetaria hulumtuese, e institucione të tjera të dedikuara për përmirësimin e këtij sektori. Ankesat më të mëdha lidhur me këtë sektor ndërlidhen me mangësi të ndryshme në dispozitat ligjore, mungesën e trajnimeve adekuate, planifikimet e dobëta, mungesën e vullnetit të mirë dhe integritetit, mungesën e transparencës dhe llogaridhënies, mundësitë për keqpërdorime, keq menaxhimet, mos arritja e vlerës për parane, etj. Këto shqetësime janë të theksuara edhe në raporte të ndryshme të publikuara si nga Institucionet ndërkombëtare, por edhe nga ato vendore.<sup>4</sup>

Me qëllim të përmirësimit të situatës së ndërlidhur në prokurim publik, Institucionet Qeveritare janë angazhuar në përmirësimin e legjislativitetit ekzistues, si dhe krijimin e legjislativitetit sekondar për të adresuar mangësitë e identifikuar. Deri më tani janë bërë gjashtë (6) ndryshime në Ligjin e Prokurimit Publik, dhe KRPP dhe agjencitë tjera janë angazhuar në ndryshime shtesë në ligjin aktual. Këto ndryshime, sado të mira në adresimin e mangësive, kanë paraqitur një sfidë në trajnimin e vazhdueshëm të Zyrtarëve të Prokurimit, por edhe sensibilizimin e Operatorëve Ekonomik.

Në bazë të hulumtimeve dhe raporteve të ndryshme, shumë institucione kanë dështuar të marrin punët dhe furnizimet me çmimet e tregut dhe vlerë për parane, që është një prej parimeve themelore në prokurimin publik, prandaj ky ka qenë edhe qëllimi kyç i krijimit të Prokurimit të centralizuar. Një theks I veçantë bie mbi furnizimet me karburante, ku insti-

Tridhjetë e shtatë (37) Autoritetet Kontraktuese të përfshira në këtë kontratë kanë të buxhetuara së bashku mbi 110 Milion Euro në Mallrat dhe Shërbimet dhe Shpenzime Kapitale, ku rreth 50 Milion Euro shpenzohen përmes procedurave të Prokurimit Publik. Rreth 10% këtyre shpenzime janë të planifikuara për prokurimin e karburanteve, të cilat përfshijnë naftë për automjete, benzinë për automjete, naftë për gjenerator dhe naftë për ngrohje.

tucionet më së shpeshti nuk kanë arritur të sigurojnë një çmim të arsyeshëm, dhe shumë shpesh i kanë paguar çmimin edhe më të lartë se ai i tregut me pakicë.

Një tjetër problem janë edhe çmimet jo normalisht të ulëta në prokurimin publik në Kosovë, që vë në mëdyshje kualitetin e shërbimit apo produktit, por edhe dëmton përfitimet e bizneseve. Gjithashtu, në raste të ndryshme vërehet se edhe pse kemi çmime jo normalisht të ulëta në një apo më shumë artikuj, vlerat e faturave janë më të larta se ato të tregut me pakicë, gjë që do të thotë se OE kanë manipuluar, respektivisht fyer çmimet në pozicione të caktuara të shërbimeve të kontraktuara.

Në bazë të analizës së kryer nga KDI në këtë raport, mund të konkludojmë se kjo kontratë e centralizuar, e para e këtij lloji, kishte arritur të siguronte kushte më të mira të menaxhimit të kontratës, mirëpo mangësi e këtyre blerjeve është limitimi i konkurrencës, që bie ndesh me Ligji Nr. 03/L-229<sup>5</sup> dhe Ligjin 04/L-226 për mbrojtjen e konkurrencës,<sup>6</sup> dhe DRAFT Strategjinë Kombëtare për Prokurimin Publik që synon të rris mbështetjen e NVM-ve.<sup>7</sup>

4 Raportet: BE\_2590\_PECK\_AC assessment report\_FINAL\_ALB; BE\_2590-PECK-AC\_Compliance\_Matrix\_Alb; BE\_2590-PECK-AML-CFT\_Follow\_up\_Report\_F\_Alb; EU\_Progress Report Kosovo 2014, EU\_Progress Report Kosovo 2015, KDI\_NIS Report 2015;

5 <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2727>

6 <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=9326>

7 <https://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=Home&LID=1&PCID=-1&CID=HTMLStatic&CID=PPRCNews&ID=234>





# ANALIZA E KONTRATËS

## VLERËSIMI I NEVOJAVE DHE PLANIFIKIMI

Karburantet, si burim i energjisë, në ditët e sotme janë mëse të nevojshme për zhvillimin e operacioneve ditore në të gjitha instancat, duke përfshirë këtu edhe Institucionet Publike. Këto nevoja janë të planifikuara dhe të buxhetuara nga secili institucion në baza vjetore, të cilat paraqiten para komisioneve vlerësuese dhe Kuvendit për miratim. Duke marr parasysh nevojën e paevitueshme për blerjen e karburanteve, vlerat e mëdha të blerjeve, çmimet e ndryshme të paguara nga Institucionet për të njëjtin produkt, për sasi të përafërta nga të njëjtin furnitor, si dhe të përfolurat si një nga sektorët më të keq menaxhuara, me qëllim të përm-bushjes së rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm, si dhe me kërkesë të aso kohe Ministrit të Financave, Agjencia Qendrore e Prokurimit filloi procesin e hulumtimit dhe analizimit të nevojave dhe tregut për furnizim me karburante për Institucionet Publike. Ky projekt u mbështet nga Institucione të ndryshme si Banka Botërore (Projektin Quick Gains Kosovo), Projekti i Reformës së Administratës Publike në Kosovë, Zyra Ndërlidhëse Evropiane (Projektin e Reformës së Prokurimit Publik) dhe SIGMA. Gjatë periudhës katër (4) mujore (nëntor 2012 – shkurt 2013) AQP kishte kërkuar informacione nga Institucione Qendrore dhe Lokale lidhur me shërbimet e tyre aktuale dhe interesin e tyre për prokurim të përbashkët, të cilat ju raportuan Bankës Botërore, Institucioneve Qeverisëse, dhe akterëve të ndryshëm në proces. Ky raport paraqet një analizë mjaft të detajuar të vullnetit të Institucioneve, çmimet që paguajnë, sasi të kontraktuara, numrin e ofertave të pranuar, numrin e ofertuesve të përgjegjshëm, listën e furnitorëve, si dhe analizën e përparësive të prokurimit të përbashkët si dhe sfidat. Nga kjo analizë


Sipas planeve të prokurimit të dorëzuara në AQP nga autoritetet kontraktuese që kanë hyrë në kontratë të përbashkët, sasia e përafërt e nevojshme e këtyre derivateve është rreth katër (4) milion litra në vit

**TABELA 1.0** Krahasimi i premiumit nga të dhënat e mbledhura nga AQP për raportin e datës 20.02.2013





**TABELA 2.0** Paraqitja e premiumit krahas sasive të kontraktuara për vitin 2013



Mos posedimi i çmimeve të berzës nga Autoritetet Kontraktuese ka lënë përpilimin e çmimeve për faturim në mëshirën e Operatorëve Ekonomik, ku shumë shpesh çmimi me Premium më të ulët është paguar nga Institucionet më shtrenjte se çmimi për litër në tregun me pakicë.

mund të konkludojmë se mesatarja e premiumit për naftë të paguar nga Institucionet ishte 0.0720 Euro/Litër, përderisa mesatarja e ofertuesve ishte tre (3) ofertues për tender, dhe mesatarja e ofertuesve të përgjegjshëm ishte dy (2).<sup>8</sup>

Nga parimet e tregut (Ekonomiks), kur oferta rritet, çmimi bie, megjithatë kur krahasojmë premiumet e paguara paraprakisht nga këto institucione shohim se ky nuk ishte rasti tek furnizimi me derivate, respektivisht për këtë analizë. Ky raport na tregon se QKUK paguante premiumin më të lartë prej 0.15 Euro për 15,000L, Ministria e Integrimi paguante premiumin më të ulët prej 0.03Euro për sasinë prej 11,538L, Ministria e Diasporës paguante 0.090Euro për

sasinë më të ulët prej 9,075L përderisa Policia e Kosovës si shfrytëzuesi më i lartë paguante 0.0955Euro për 4,100,100L, që është 0.03Euro më shumë se që paguanin Ministria e Diasporës dhe Forcës e Sigurisë prej rreth 0.065 për sasinë afër 1,000,000L, që do të thotë se Policia e Kosovës, e kuantitetin më të lartë, ka paguar rreth 120,000 Euro në total më shumë se mesatarja që paguanin Institucionet tjera.

Tabelat e më sipërme pasqyrojnë më së miri nevojën për një prokurim të përbashkët, me qëllim të kursimit të parasë publike krahas një blerjeje të arsyeshme. AQP në analizën e bërë kishte paraparë një kursim mesatar prej 6% krahas çmimeve që paguheshin në vitin 2012, apo një premium në vlerën mesatare prej 0.05Euro/Litër<sup>9</sup>.

Gjithashtu këto institucione kishin lidhur kontrata në të cilat çmimi bazë i derivatit i referohej çmimit mesatar mujor të berzës. Për të marrë çmimet e berzës, secili Autoritet Kontraktues (160 AK) duhej të paguanin anëtarësimin në PLATTS në vlerë prej dy (2) Milion Euro në vit, shpenzim ky që do të evitohet me prokurim qendror ku do të paguhej vetëm një anëtarësim.

Tabela 3.0 Përqindja e pjesëmarrjes të llojit të karburanteve krahas sasisë totale të parashikuar për 36 muaj për institucion

<sup>8</sup> Republika e Kosovës - Ministria e Financave - Agjencia Qendrore e Prokurimit - Raport – Analizë - Furnizim me Karburante, Prishtinë, 20 Shkurt 2013


<sup>9</sup> Agjencia Qendrore E Prokurimit - Raport – Analizë - Furnizim me Karburante, Prishtinë, 04 Mars 2013



|||||



**TABELA 3.0** Përqindja e pjesëmarrjes të llojit të karburanteve krahas sasisë totale të parashikuar për 36 muaj për institucion



|||||

|)|)|)|)|)|)|)|)|)|)|)|)|)|)|)|)|)|)|)|)|)|)|)|)|)|)|)|)|)|)|)|)|)|)|)|)|)|)|)|)|)|)|)|)|)|)|)|)|)|)|)|)|)|)|)|)|)|)|)|)|)|)|)|)|)|)|)|)|)|)|)|)|)|)|)|)



TABELA 4.0 Pasqyrim i sasive të përafërta për produkt e kërkuar nga secili Autoritet Kontraktues i përfshire në kontratë

Nr	EMRI I AUTORITETIT KONTRAKTUES	SASIA E PARASHIKUAR PËR 36 MUAJ			
		Diesel për vetura dhe mjete tjera lëvizëse-Litra (10 ppm)	Diesel për Gjenerator Litra (10 ppm)	Diesel për nxeheje Litra (10 ppm)	Benzinë për vetura Litra (10 ppm)
1	Prokuroria e Shtetit	280,000	50,000	80,000	40,000
2	Agjencia e Kosovës për Inteligjence	120,000	60,000	180,000	2,000
3	Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa	12,000	0	0	0
4	Agjencia Qendrore e Prokurimit	12,000	0	0	0
5	Ministria e Administrimit te Pushtetit Lokal	90,000	0	0	0
6	Komision Rregullativ i Prokurimit Publik	16,000	0	0	8,000
7	Ministria e Administratës Publike	180,000	120,000	300,000	6,000
8	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	272,000	1,100	30,000	0
9	Dogana e Kosovës	600,000	150,000	75,000	6,000
10	Agjencia Kundër Korrupsionit	11,000	4,600	15,000	15,500
11	Iber Lepenc	282,861	2,378	0	895
12	Qendra e Kosovës për Transfuzion te Gjakut	27,000	4,000	0	4,400
13	Agjencia e Statistikave te Kosovës	21,000	0	0	20,000
14	Ministra e Diasporës	46,800	0	0	0
15	Këshilli i Sigurisë se Kosovës	22,500	0	0	0
16	Zyra e Kryeministrit	144,000	0	0	79,200
17	Ministria e Integrimit Evropian	35,400	0	0	15,000
18	Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave	0	1,800	9,000	24,000
19	Komuna e Novobërdës	94,000	8,000	18,000	2,000
20	Akademia e Shkencës dhe Arteve	14,000	0	0	14,000
21	Agjencia Kadastrale e Kosovës	41,190	0	0	0
22	Agjencia Shtetërore e Arkivave te Kosovës	9,300	0	0	9,064
23	Zyra e Rregullatorit për Energji	20,900	900	0	0
24	Institucioni i Avokatit te Popullit	36,000	4,400	12,000	4,200
25	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	56,800	2,000	3,000	5,550
26	Spitali Rajonal Prizren	48,000	60,000	0	12,000
27	Ministria e Drejtësisë,	82,797	6,367	0	26,403
28	Shërbimi Korrektues i Kosovës	318,750	83,333	1,458,333	10,417
29	Agjencia për Administrimin e Pasurisë se Sekuestruar dhe te Konfiskuar	35,418	2,300	2,300	2,300
30	Ministria e Financave	90,000	15,000	45,000	15,000
31	Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë	162,498	9,416	35,832	581
32	Administrata Tatimore Kosovës	375,000	0	255,000	45,000
33	Komuna e Graçanicës	16,000	8,000	38,000	27,000
34	TRAINKOS SH.A	2,700,000	0	0	0
35	Këshilli Gjyqësor i Kosovës	540,000	180,000	1,300,000	70,000
36	Zyra Rregullatore për Ujësjellës dhe Kanalizim	2,100	3,000	12,000	15,000
37	Instituti Gjyqësor i Kosovës	12,000	6,000	34,000	0
<b>Totali i sasive te përafërta për 36 muaj</b>		<b>6,827,314</b>	<b>782,594</b>	<b>3,902,465</b>	<b>479,510</b>

|)|)|)|)|)|)|)|)|)|)|)|)|)|)|)|)|)|)|)|)|)|)|)|)|)|)|)|)|)|)|)|)|)|)|)|)|)|)|)|)|)|)|)|)|)|)|)|)|)|)|)|)|)|)|)|)|)|)|)|)|)|)|)|)|)|)|)|)|)|)|)|)|)|)|)|)

## PËRGATITJA E SPECIFIKACIONEVE TEKNIKE DHE DOSJES SË TENDERIT

Specifikat teknike të për këtë kontratë janë të titulluara si specifikat specifikimet teknike të detyrueshme, ku përfshihen sasishtë, specifikimet teknike të kualitetit të produktit si dhe kërkesat e përgjithshme<sup>10</sup>.

Specifikat teknike, për sa ju përkasin sasive për Institucion dhe sasive të akumuluar janë paralogaritur nga Autoritetet Kontraktuese dhe përfshirë në Planet e Prokurimit të dorëzuara në AQP.

**TABELA 5.0** Sasishtë e përafërta të furnizimeve për 36 muaj

#	Përshkrimi i produktit	Njësia matëse	Sasia e përafërt për 36 muaj
1	Diesel për vetura dhe mjete tjera lëvizëse 10 ppm	Litra	6,827,314.00
2	Diesel për Gjenerator 10 ppm	Litra	782,594.00
3	Diesel për Ngrohje 10 ppm	Litra	3,902,465.00
4	Benzinë për vetura ( 95 dhe 98) 10 ppm	Litra	479,510.00

Specifikimet teknike të kualitetit të produktit, janë përpiuar konform Udhëzimit Administrativ Nr. 07/2012 të aprovuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë me datën 27.04.2012<sup>11</sup>, i cili përcakton kualitetin e derivateve që janë të lejuara të importohen në Kosovë. Këto specifika adresojnë kualitetin e derivateve si në vijim:

- o Specifikimi teknik për (Diesel për vetura dhe mjete tjera lëvizëse 10 ppm, Diesel për gjenerator 10 ppm, Diesel për nxeheje 10 ppm)
- o Specifikimi teknik Petrol 95 (Benzinë për vetura 10 ppm)
- o Specifikimi teknik Petrol 98 (Benzinë për vetura 10 ppm)

10 Dosja E Tenderit Ri-Tender, Për Kontratën Publike Kornizë – Furnizim, Me një Operator Ekonomik, Procedurë e Hapur  
11 <http://www.mti-ks.org/sq/Udhhezimet-Administrative/page/6>

Në vijim, AQP ka përfshirë edhe kërkesat e përgjithshme si në vijim:

*Pranueshmëria e Operatorëve Ekonomik*, ku Operatorët Ekonomik duhet të përmbushin kërkesat e specifikuar në nenin 65 të Ligjit të Prokurimit Publik (LPP), Ligji nr. 04 \ L-42<sup>12</sup>.

### Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale:

- o Certifikata e regjistrimit të biznesit-kopje
- o Certifikata e TVSH-kopje
- o Certifikata e numrit fiskal-kopje
- o Kopje të Licencave për shërbime në sektorin e karburanteve:
  - Licencën e importit,
  - Licencën për deponim
  - Licencën e shitjes me shumicë,
  - Licencën e transportit dhe
  - Licencën e shitjes më pakicë për pikat e karburantit ku Operatori Ekonomik ofron furnizime me derivate e të cilat i ka në pronësi apo të marra me qira.

*Të gjitha licencat e lëshuara nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë duhet që të kenë afat të validitetit.*

*Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare*, ku Operatori Ekonomik është kërkuar të prezantoj pasqyrat financiare të audituara për vitet 2011, 2012 dhe 2013, të cilat dëshmojnë se OE ka pasur një qarkullim vjetor jo më pak se **15,000,000.00** EURO gjatë kësaj periudhe.

Nëse e analizojmë kërkesën e më sipërme do të vërejmë se është paksa e paqartë nëse shuma e kërkuar është në total 15 Milion Euro për tri (3) vite apo për secilin vit veçmas. Meqë kërkesa cek se qarkullimi duhet të jetë vjetor, atëherë kjo len të nënkuptohet se qarkullimi i kërkuar për tri vitet në fjalë është 45,000,000.00 Euro, që është një shumë mjaft e madhe dhe jo e përbalueshme për shumë Operator Ekonomik, dhe në mënyrë automatike zvogëlon nurin e konkurrencës.

Në komunikimin me zyrtarin e AQP është qartësuar se shuma e kërkuar është në total për të tri (3) vitet në fjalë, mirëpo një konfuzion i tillë mund të ketë trembur konkurrencën e mesme dhe të vogël, duke u bazuar në numrin shumë të vogël të konkurrentëve, të cilët kanë mundur ta nënkuptojnë se shuma e qarkullimit të kërkuar është 15 Milion Euro për vit<sup>13</sup>.

12 <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2772>

13 Komunikimi përmes e-mailit me Behram Abazi, Drejtor i Projekteve Speciale AQP, RE: Pyetje rreth kontrates për furnizim me derivate, data Fri, Dec 4, 2015.

|||||



**TABELA 6.0** Vendet e pikave te shitjes te cilat kërkohen me kontratë.

NR.	LOKACIONI	NR.	LOKACIONI
1	Prishtine	16	Lipjan
2	Peje	17	Glllogoc
3	Gjakove	18	Shtërpce
4	Kline	19	Kaçanik
5	Gjilan	20	Suharekë
6	Kamenice	21	Malisheve
7	Viti	22	Rahovec
8	Klllokot	23	Dragash
9	Novobërdë	24	Deçan
10	Mitrovice	25	Istog
11	Prizren	26	Skenderaj
12	Ferizaj	27	Vushtrri
13	Graçanicë	28	Leposaviq
14	Hani i Elezit	29	Zubin Potok
15	Podujeve		

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale:

- Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses Furnizime me karburante gjatë tre viteve të fundit (2011-2012-2013) jo më pak se **7,000,000.00 Euro**.
- Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka në pronësi apo të marra me qira mjetet transportuese për realizim të kontratës së paku 3 autobot për diesel dhe 1 autobot për benzinë.
- Operatori Ekonomik duhet të dorëzojë një listë të pikave të shitjes se karburanteve që planifikon për të shfrytëzuar për realizimin e kontratës.

Sipas kërkesave të përgjithshme operatori ekonomik, duhet të ofroj gjithsej 29 pika të shitjes në gjithë territorin e Kosovës të listuar në tabelën 6.0 në vijim:

Vetëm për tenderuesin që propozohet që të shpërblehet me kontrate dhe dorëzohen të Autoriteti Kontraktues para publikimit të Njoftimit për Dhënie të Kontratës:

- a.** Deklarate nga Operatori Ekonomik i cili deklaron se do të mbajë në depon e tij pa asnjë kompensim

karburantet e konfiskuara nga Dogana e Kosovës, **përafërsisht deri në 50,000 litra**.

Ky ka qenë një kriter përfutës për buxhetin e Kosovës, megjithatë gjatë intervistës me përfaqësues të Doganës së Kosovës, u parashtrua problemi teknik i mos përfshirjes apo adresimit të mjeteve të transportit, apo çmimit të transportit, nga pika e konfiskimit të derivateve, deri tek pikat e deponimit, që kishte rezultuar si një lëshim nga Autoriteti Kontraktues. Shërbimet për furnizim me derivate për Doganën e Kosovës kanë hyrë në fuqi nga data 05 tetor 2015, kur edhe është paraqitur problem me mungesën e kriterëve për transportimin e derivateve të konfiskuara. Dogana e Kosovës është në bisedime me AQP për mundësitë e përmirësimit të kësaj situatë përmes një anekse kontrate apo një kontrate tërësisht të re.<sup>14</sup>

- b.** Deklaratë nga Operatori Ekonomik, i cili deklaron se në rast krize për karburante, Operatori Ekonomik do të mbajë në rezervat e tij të dedikuara për Agjencinë Qendrore të Prokurimit - Diesel **300,000 litra** dhe Benzinë **50,000 litra**

- c.** Deklaratë nga Operatori Ekonomik i cili deklaron se merr për obligim kompensimin e të gjitha dëmeve

<sup>14</sup> Takimi me Udhëheqësit e Zyrës për Media dhe Departamentit të Prokurimit, data 16 nëntor 2015.

|||||



Kriteret e përdorura në kushtet e kontratës janë pare si të paarrtshme për NVM-të, dhe kanë ndikuar në tërheqjen e tyre nga pjesmarrja në procesin e tenderimit!

ndaj automjeteve të Autoriteteve Kontraktuese, në rast se është konstatuar se dëmet e shkaktuara vijnë si pasoje e kualitetit të dobët të karburanteve.

**Siguria e tenderit** - Shuma e Sigurimit të Tenderit duhet të jete 450,000.00 € me kohëzgjatje 120 dite prej datës së pranimit të ofertave.

**Siguria e ekzekutimit** - Shuma e Sigurisë së Ekzekutimit është: 1,400,000.00 € me kohëzgjatje prej 37 muaj prej

datës së nënshkrimit të kontratës. Shuma e kërkuar për siguri të ekzekutimit është rumbullakësim i çmimit të shërbimeve të parapara për periudhën katër (4) mujore, apo 10% i shumës totale nga planifikimi i prokurimit.

Një kriter tjetër i kërkuar nga AQP ka qenë që largësia maksimale e pikave të karburantit që Operatori Ekonomik ka ne pronësi apo të marr me qira mund të jetë deri në 10 km nga qendra e qytetit. Për pikat e karburantit që nënkontraktohen, largësia maksimale mund të jete deri në 5 Km nga qendra e qytetit.

Gjatë grupit të fokusit të organizuar nga KDI, nga pjesëmarrësit në takim u potencua se problemi kryesor me kontratë të centralizuar është zvogëlimi i konkurrencës, duke marrë parasysh që kriteret e dosjes së tenderit ishin të pa përballeshme për Operatorët Ekonomik të vegjël, dhe se ato favorizonin kompanitë e mëdha, dhe fuqizimin e monopoleve në tregun e derivateve.

Sipas “Graniti Petrol” - Vushtrri, një nga problemet kryesore është liria që Ligji për Prokurim Publik i jep Zyrtarëve të Prokurimit për përcaktimin e kriterëve sipas dëshirave të tyre.



**TABELA 7.0** Tabela informuese për llogaritjen e çmimit kushtues të karburanteve

NR	Përshkrimi	Fiks/Variabil
1	Berza mesatare mujore - CIF Med (Genova/Lavera Ton/\$)	Variabil
2	Premiumi i rafinerisë në \$/ ton	Fiks
3	Çmimi i rafinerisë (1+2) \$/ton	Variabil
4	Kursi mesatar mujor \$/euro sipas Bankës Qendrore Evropiane	Variabil
5	Çmimi i tonit në Euro (3X4)	Variabil
6	Shndërrimi i tonit në litër	Fiks Një (1)Ton diesel = 1 191 litra Një (1) Ton benzine = 1 368 litra
7	Çmimi për litër në Euro (5/6)	Variabil
8	Çmimi i transportit për litër	Fiks: 500.00 € /30.000 litra
9	Çmimi para taksave (7+8+9)	Variabil
10	Akciza për litër	Fiks sipas ATK (mund të ndryshoj vetëm nëse ndryshojnë ligjet e ATK)
11	GJITHSEJ (10+11)	Variabil
12	Premiumi i kompanisë / litër sipas ofertës dhe kontratës	Fiks
13	Gjithsej çmimi me Premium (12+13)	Variabil
14	TVSH 16% / litër	Fiks 16 % sipas ATK (mund të ndryshoj veten nëse ndryshojnë ligjet e ATK)
15	Çmimi për litër për faturim (14+15)	Variabil





Po i njëjti Operator Ekonomik kishte parashtruar një ankesë pranë OSHP lidhur me kriteret diskriminuese, respektivisht shkelje të Nenit 7 - Barazia në trajtim/Jo Diskriminimi, të LPP-së por që OSHP kishte marrë vendim (Nr. 152/14) në favor të Autoritetit Kontraktues (AQP) si e pa bazuar<sup>15</sup>.

Sipas po të njëjtit Operator Ekonomik, ka një mos përputhshmëri ndërmjet kriteve sepse, sasia prej afërsisht 11,000 Litrash derivate në ditë nuk paraqet ndonjë problem për shumicën e OE, mirëpo shumata e qarkullimeve të parasë, si dhe kontratatave të përfunduara me sukses, janë të paarrtshme për shumë biznese të vogla. Në vijim, Graniti Petrol e sheh si diskriminues kërkesën e AK ku furnitori ka për obligim që në rezervat (deponitë) e tij çdo here t'i mbaj në rezervat minimum: Diesel 300.000 litra dhe Benzinë (95,98)- 50.000 litra, si një kriter i pabazë, mirëpo, sipas AQP ky kriter është vendosur për të siguruar se në rast krize të derivateve, AK nuk do të mbesin pa furnizimet e duhura<sup>16</sup>.

Në tabelën për ndërtimin e çmimeve, AK ka specifikuar parametrat për shfrytëzim në ndërtim të çmimeve, të cilat karakterizohen në fikse dhe variabile.

Gjatë analizimit të këtyre parametrevë është vërejtur se dy çmime ekonomishtë variabile ishin listuar nga AK si çmime fikse.

1. Premiumi i rafinerisë – është listuar si çmim fiks edhe pse rafineritë janë private, dhe kanë premiume të ndryshme, të cilat ndryshojnë edhe në bazë të rabateve sasiore.
2. Çmimi i transportit për Litër – gjithashtu është listuar si çmim fiks, edhe pse kostoja e transportit ndryshon varësisht nga distanca e furnizimit.

Gjatë analizës së ofertave të operatorëve ekonomik është vërejtur se asnjëri nga OE nuk kishte konkurrar me po të njëjtën origjinë të furnizimit.

**TABELA 8.0** Vendi i furnizimit sipas ofertuesve

OFERTUESI	VENDI I FURNIZIMIT
PETROL COMPANY	ITALIA
HIB PETROL	OKTA MK
PATRONI & EIDA	GREQI

15 <https://oshp.rks.gov.net/repository/docs/vendimet/2014/Furnizim-me-karburante-aqp.pdf>

16 Takimi me AQP, data 10 nëntor 2015

Gjatë analizimit të kushteve të tenderit, është vërejtur edhe një përkufizim i njësive variabile në ndërtimin e çmimeve për litër.

Sipas disa intervistave me OE, premiumet e rafinerive variojnë nga USD 45.00 deri në USD 75.00 për Ton, dhe po ashtu çmimi i transportit për litër varion nga 0.0167 €/Litër për furnizimet nga Maqedonia, dhe 0.0333/Litër për furnizimet nga Greqia, Bullgaria apo Shqipëria. Pohimet ishin se për furnizimet nga Italia, kostoja e transportit ishin rreth apo mbi 0.050 €/Litër.<sup>17</sup> Gjatë këtyre intervistave u vu në pah se Premiumi i rafinerisë në vlerë prej USD 50.00/Ton ishte mesatarja e rafinerisë OKTA në Maqedoni, si dhe çmimi i transportit 0.0167 Euro/Litër është çmimi i transportit nga Maqedonia në Kosovë.

Në pikëpamje të parë, duket sikur AK, në mënyrë indirekte, ka favorizuar rafinerinë OKTA në Maqedoni.

Gjatë takimit sqarues me AQP rreth vendosjes së këtyre kriteve, AK argumentoi se arsyeja e vendosjes së këtyre para masave variabile si, para masa fikse, ka qenë mbrojtja e Fondeve Publike nga fryrja e çmimeve, siç ka ndodhur në të kaluarën, ku mesatarja e transportit të paguar nga Institucionet ka qenë 0.0333 Euro/Litër (1,000.00 Euro për maune), dhe sidomos që me përmirësimin e infrastrukturës rrugore, kjo kosto ndodh të jetë edhe më e ulët. Një gjë e tillë e fryrjes së çmimeve të transportit është potencuar edhe nga KDI, ku çmimet kanë luajtur nga 500.00 Euro/Maune deri në 3,000.00 Euro/Maune.<sup>18</sup>

Po e njëjta arsye është dhënë nga AK edhe për paracaktimin e premiumit të rafinerisë, sepse sipas AQP, kompani të ndryshme kanë prezantuar premiume të ndryshme dhe kur është bërë llogaritja e premiumeve për kompanitë që furnizojnë institucione të ndryshe, është arritur në përfundim se mesatarja e premiumeve të rafinerive të paguar ishte USD 50.00/Ton. Gjithashtu, sipas AQP, poqëse do të kishte ndonjë ndryshim në Premium të rafinerisë, OE ka pasur mundësinë që këtë ndryshim ta përfshijnë brenda premiumeve të ofertuara për Litër.<sup>19</sup>

17 Intervistë telefonike me përfaqësues ligjor të HIB Petrol (03 nëntor 2015) dhe Patroni (19 tetor 2015)

18 Instituti Demokratik I Kosovës, Tenderët Kaotik të Komunave, Prishtinë, Qershor 2015

19 Intervistë personale me Behram Abazi, Drejtor I Projekteve Speciale, AQP, data 11 tetor 2015

Shoqata e naftarëve shpreh shqetësim, dhe janë kundër dhënies së një kontrate me një vlerë aq të lartë një operatori ekonomik të vetëm.<sup>20</sup> Në këtë kontest, KDI po ashtu ka ngritur si shqetësim limitimin e konkurrencës si pasojë e tenderimit për Kontratë me një Furnizues<sup>21</sup>, me ç’rast përgjigja e AQP ka qenë se misioni i AQP është të siguroj vlerën më të mirë për paranë, duke kursyer paranë publike. Po ashtu, mbi 50% të pikave të furnizimit në kontratën aktuale janë të nënkontraktuara me ndërmarrje të vogla dhe të mesme, që nuk do të thotë se konkurrenca është limituar apo dëmtuar me këtë kontratë.

Çmimet jo normalisht të ulëta bien ndesh me motivin kyç të bizneseve që është fitimi financiar

## VLERËSIMI I OFERTAVE

AQP ka shpallur tenderin AQP-AK-14-002-111 me datën 27 janar 2014<sup>22</sup>, dhe në mungesë të ofertuesve me datën 03 mars 2014<sup>23</sup> kanë publikuar vazhdimin e afatit për tenderim deri më 18 mars 2014. Në përgjigje të këtij tenderi kishin ofertuar dy kompani HIB Petrol dhe Patroni. Gjatë vlerësimit të ofertave të pranuar është vërtetuar se kompania Patroni nuk i posedonte të gjitha licencat e kërkuara, dhe me datën 27 mars 2014 kishin publikuar njoftimin për anulimin e kontratës nën arsyen se “Anulimi këtij aktiviteti të prokurimit është bërë në mungesë të ofertave të mjaftueshme të përgjegjshme”<sup>24</sup>. Më datën 28 mars 2014, NTSH Patroni ka parashtruar një ankesë pranë OSHP, nën pretekstin se anulimi i tenderit ka qenë jo i drejtë, dhe AK ka bërë shkelje të LPP-së, respektivisht Neneve 59, 66 dhe 72. Kjo ankesë është refuzuar nga OSHP si e pabazë, me datën 24 prill 2014, vendimi 52/14.<sup>25</sup>

AQP ka ri tenderuar shërbimet në fjalë me datën 08 Maj 2014.<sup>26</sup> Në përgjigje të ri tenderimit, kanë aplikuar tri (3) kompani Petrol Company, HIB Petrol dhe NTSH Patroni & Euro Petrol Durrës Shqipëri dega Kosovë.<sup>27</sup>

Gjatë vlerësimit të ofertave të pranuar nga komisioni vlerësues është arritur në përfundim se të gjithë operatorët ekonomik që kishin ofertuar në përgjigje të re-tenderit Nr. AQP-AK-14-002-111 ishin të përgjegjshëm. Me datën 11 Qershor 2014, AQP i kishte dërguar Petrol Company një kërkesë për sqarime rreth çmimit jo normalisht të ulët, dhe me datën 16 qershor 2014, kishin pranuar përgjigje nga OE se ata kishin rabat sasior nga rafineria e furnizimit. Në bazë të kriterit të çmimit më të ulët, dhe sqarimeve të pranuar nga Petrol Company, OE fitues i këtij tenderi ishte Petrol Company, me premiumin prej 0.0001 Euro/Litër.

Me datën 04 korrik 2014, HIB Petrol kishte parashtruar një ankesë pranë OSHP lidhur me vendimin e AQP për dhënie të kontratës Petrol Company, nën pretekstin se ishte bërë shkelje e LPP-së, respektivisht, Nenet 59, Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve. Gjatë hulumtimit të bërë nga eksperti shqyrtues i OSHP është vërtetuar se kompania e shpallur fituese nuk i kishte të gjitha licencat valide, respektivisht licenca nr. 1862 për regjionin e Gjilanit kishte afat të skaduar, dhe meqë OE në dosjen e tenderit kishte deklaruar se kjo licence kishte validitet deri më

20 Intervistë personale me Fadil Berjani, Kryetar i Shoqatës së Naftarëve të Kosovës, data 04 dhjetor 2015

21 Ri-Tenderim për Kontratën Publike Kornizë – Furnizim Me Një Operator Ekonomik, AQP-AK – 14-002-1-1-1

22 <https://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=Notices&LID=1&P-CID=-1&CtlID=ViewNotices&ID=81576>

23 <https://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=Notices&LID=1&P-CID=-1&CtlID=ViewNotices&ID=82464>

24 <https://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=Notices&LID=1&P-CID=-1&CtlID=ViewNotices&ID=83343>

25 <https://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2014/-Furnizim--me--karburante-.pdf>

26 <https://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=Notices&LID=1&P-CID=-1&CtlID=ViewNotices&ID=85023>

27 Procesverbal i hapjes së ofertave Furnizim me karburante- AQP-AK-14-002-111 Ri-tender

FIG 1.0 Pasqyrim nga Procesverbal i hapjes së ofertave.

Nr. Br.	Tenderuesi Tenderer Tenderer	Vendi: Country: Mesto:	Çmimi Price Cena e	Vërejtje PO/JO Remarks YES/NO Napomena DA/NE	Përfaqësuesi i OE / EO Representative/Zastupnik EO	
					Emri / Mbiemri Name / Surname Ime / Prezime	Nënshkrimi Signature Potpis
1	Petrol Company	Prishtinë	1.195,18	—	FATOS SHALA	
2	HIB Petrol	Ferizaj	278.367,06	—	Artan Beqiri	
3	NTSH Patroni & Euro Petrol Durrës Shqipëri Dega Kosovo	Prishtinë	827.430,51	—	DRILON THAÇI	

|||||



**TABELA 9.0** Krahasimi i ofertave financiare të pranuar në përgjigje të ri-tenderit AQP-AK-14-002-111

Përshkrimi	TOTAL Sasia/36 Muaj	Njësia	Petrol Company		HIB Petrol		Patroni	
			Çmimi/Njësi	Çmimi/Total	Çmimi/Njësi	Çmimi/Total	Çmimi/Njësi	Çmimi/Total
DIESEL 10 ppm AUTOMOBILE	6,827,314.00	Litër	0.0001	682.7314	0.0260	177,510.1640	0.0690	471,084.6660
DIESEL 10ppm GENERATOR	782,594.00	Litër	0.0001	78.2594	0.0199	15,573.6206	0.0690	53,998.9860
DIESEL 10ppm HEATING	3,902,465.00	Litër	0.0001	390.2465	0.0199	77,659.0535	0.0690	269,270.0850
GASOLINE 10ppm AUTOMOBILE 95,98	479,510.00	Litër	0.0001	47.9510	0.0159	7,624.2090	0.0690	33,086.1900
<b>TOTAL</b>				<b>1,199.1883</b>		<b>278,367.0471</b>		<b>827,439.9270</b>

datën 31.01.2015, OSHP kishte vlerësuar se ky OE ishte i papërgjegjshëm dhe kishte marr vendimin për anulimin e kësaj dhënie të kontratës, me urdhrin që kjo dosje të kthehej në rivlerësim (Vendimi Nr. 222/14, data 01 Gusht 2014)<sup>28</sup>.

Në bazë të këtij vendimi, me datën 07 gusht 2014, AQP kishte publikuar anulimin e dhënies së kontratës Petrol Company-së<sup>29</sup>.

Me datën 11 gusht 2014 ka filluar procesi i rivlerësimit të ofertave të pranuar në përgjigje të tenderit AQP-AK-14-002-111. Si rrjedhojë e ri-vlerësimit është kërkuar edhe një herë nga MTI që të verifikohen të gjitha licencat e ofruara nga të gjithë operatorët ekonomik, si dhe të verifikohen referencat e prezantuara nga OE "NTSH Patroni & EIDA" Dega Kosovë. Vlerësimi i ofertave ka vazhduar me datën 22 gusht 2014, pasi ishin pranuar të gjitha vërtetimet dhe dëshmitë e kërkuara paraprakisht. Me këtë rast është vlerësuar se oferta e OE Petrol Company ishte e papërgjegjshme në mungesë të gjitha licencave valide për pikat e shitjes me pakicë, dhe ishte rekomanduar që të shpërblehej me kontratë OE HIB Petrol me premiumin total prej 278,367.046 Euro për total sasi të përafërta për 36 muaj. Ky rekomandim është bërë në bazë të kriterit "Çmimi më i ulët i ofertës së përgjegjshme"<sup>30 31</sup>.

28 <https://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2014/Furniz-me-karburante-aqp---.pdf>

29 <https://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=Notices&LID=1&P-CID=-1&CtlID=ViewNotices&ID=88876>

30 AQP - Procesverbal i ri-vlerësimit të Ofertave, data 22.08.2014

31 AQP - Raporti i Ri-vlerësimit të Ofertave, data 22.08.2014

## ZBATIMI I KONTRATËS, MONITORIMI I PERFORMANCËS DHE PAGESAVE

Kontrata në fjale përmban tri lloje të kushteve, Kushtet e Kontratës, Kushtet e Veçanta të Kontratës si dhe Kushtet e Përgjithshme. Gjithashtu përmban edhe dokumentacionin plotësues si: Tenderi i Furnizuesit duke përfshirë Specifikimet Teknike, Ofertën Financiare, Specifikat Teknike të detyrueshme, Listën e Autoriteteve Kontraktuese, Lokacionet e Pikave të Karburantit, Tabelën e formimit të çmimeve dhe Urdhër blerjen<sup>32</sup>. Kjo kontratë është e publikuar edhe në faqen zyrtare të AQP, komfor kërkesave për transparencë të prokurimeve publike (Publikime)<sup>33</sup>. Ky dokumentacion si tërësi përshkruan në mënyrë detajore obligimet e Autoritetit (autoriteteve) Kontraktues (e) dhe Furnitorit. Sipas Kushteve të Veçanta të Kontratës, Autoriteti Kontraktues identifikohet në dy grupe, AQP që merret me adresimin e qeshjeve kontraktuale dhe Autoritetet Kontraktuese (37) të identifikuar në listën e autoriteteve kontraktuese, të cilët janë përgjegjës për konsumimin e shërbimit, menaxhimin dhe obligimet financiare. Autoritetet Kontraktuese të specifikuar në Aneksin 6 të kontratës (Lista e Autoriteteve Kontraktuese), obligoheshin që, brenda 5 (pesë) ditëve pas pranimit të kopjes së nënshkruar të kontratës, të hartoj Planin e Menaxhimit

32 Kontrata Publike Kornizë, Kushtet & Aneksat e Ndërlidhura, Furnizim me karburante, Nr. I Prokurimit AQP-AK-14-002-111, Nr. I Kontratës 07/2014, data e nënshkrimit 15 shtator 2014.

33 <https://aqp.rks-gov.net/>

|||||



te Kontratës, si dhe brenda 7 (shtatë) ditëve të dorëzonin tek Furnizuesi një liste të veturave (me numra të regjistrimit) të autorizuara për furnizim në pompat e benzinës së Operatorit Ekonomik. Kjo listë mund të freskohej në intervale të ndryshme kohore, dhe lista e re do të hynte në fuqi vetën 24 orë pas pranimit nga Furnizuesi.

Sipas intervistës personale me Zyrtarë nga Dogana e Kosovës, si një nga shfrytëzuesit më të mëdhenjtë të këtyre shfrytëzimeve, nuk u shpreh ndonjë shqetësim lidhur me menaxhimin e kontratës, dhe u konsiderua mjaft e qartë dhe e lehtë për tu menaxhuar<sup>34</sup>. Deri më tani, të gjitha Autoritetet Kontraktuese janë në shfrytëzim të shërbimeve të ofruara nga kjo kontratë, dhe kontrata mund të cilësohet si e plotfuqishme.

Si pjesë e menaxhimit të kontratës parashihet edhe menaxhimi i cilësisë së derivateve. KDI ka dërguar disa kërkesa gjashtë (6) kërkesa për qasje në dokumente publike, dhe ka pranuar tri (3) përgjigje në këto kërkesa. Një nga dokumentet e kërkuara ka qenë edhe raporti i vlerësimit të cilësisë, i cili është prezantuar vetëm nga Administrata Tatimore e Kosovës. Këto inspektive janë kryer nga “Adriainspekt Kosova”

Figurat e më poshtme pasqyrojnë rezultatet e këtyre inspektimeve:

Kontrata në fjalë, përmban në vete edhe tabelën e përpilimit të çmimeve, të cilat kalkuloohen çdo fillim të muajit nga AQP dhe publikohen në faqen zyrtare të AQP-së. Publikimi i këtyre çmimeve ka një rol të trefishtë, faturimin nga furnizuesi, planifikimin dhe përgatitjet nga Autoritetet Kontraktuese, si dhe njoftimi i publikut dhe palëve tjera të interesit.

Në raportin e KDI për monitorimin e tenderëve të komunave, duke përfshirë edhe furnizimin me derivate, ishte vërejtur se në shumë situata Institucionet paguanin çmimin e naftës për litër më shtrenjtë se tregu me pakicë<sup>35</sup>. KDI ka krahasuar çmimet nga tregu me pakicë, i ofruar nga po i njëjti Operator Ekonomik HIB Petrol, me çmimet e publikuara nga AQP për muajt Gusht, Shtator dhe Tetor 2015.

- Me datën 01 shtator 2015, çmimi i naftës me pakicë në pikat furnizuese të HIB ka kushtuar 1.020 Euro për Litër, në ndërkohë që çmimi i publikuar nga AQP me datën 02 shtator 2015 është 0.9267 Euro/Litër, përafërsisht rreth 0.0933 më i lirë se tregu me pakicë;

34 Intervistë personale me Udhëheqësit e Zyrës për Media dhe Departamentit të Prokurimit, data 16 nëntor 2015.

35 Instituti Demokratik i Kosovës, Tenderët Kaotik të Komunave, Prishtinë, Qershor 2015

FIG 2.0 Raporti i bërë në muajin tetor 2015

Testi / Test	Metoda / Method	Specifikacionet / Specification		Njësia / Unit	Rezultati / Result
		min	max		
Numri i Cetanit / Cetane number	EN ISO 5165	51.0	-	-	56.4
Densitet në 15 °C / Density at 15 °C	EN ISO 12186	820.0	845.0	kg/m <sup>3</sup>	823.5
Hidrokarburet policiklike aromatike / Polycyclic aromatic hydrocarbons	EN 12916	-	8	% (m/m)	3.0
Përmbajtja e squfurit / Sulphur content	EN ISO 20846	-	10.0	mg/kg	6.9
Pika e ndezjes / Flash point	EN ISO 2719	55	-	°C	58.0
Përmbajtja e ujit / Water content	EN ISO 12937	-	200	mg/kg	71.0
Përmbajtja e esterit metilik të acidit yndyror (EMAY) / Fatty acid methyl ester (FAME)	EN 14078	-	7.0	% (v/v)	0.00
Lubrificueshmëria (wed 1,4) në 60 °C / Lubricity (wed 1,4) at 60 °C	EN ISO 12165-1	-	460	µm	397
Pika e distillimit 95 % (v/v) / Distillation point 95 % (v/v)	EN ISO 3405	-	380	°C	359.7
Pika e filtra blloqit për periudhën kohore gjatë vitit / Filterability point for the time period during the year					
Nga / From 01.10. deri / to 15.11.	EN 116	-	-10.0	°C	-16



|||||



**FIG 3.0** Raporti i bërë në muajin gusht 2015

Nr. i raportit laboratorik / Analiza e kryer nga: **0678/15** / **OKTA REFINERY**  
 No. of lab. report / Analysis performed by:  
 Data e raportit laboratorik / Date of laboratory report: **11.08.2015**

Testi / Test	Metoda / Method	Specifikacionet / Specification		Njësia / Unit	Rezultati / Result
		min	max		
Numri i Cetanit / Cetane number	EN ISO 5165	51.0	-	-	55.4
Densiteti në 15 °C / Density at 15 °C	EN ISO 12185	820.0	840.0	kg/m <sup>3</sup>	821.5
Hidrokarburet policiklike aromatike / Polycyclic aromatic hydrocarbons	EN 12915	-	5	% (m/m)	3.0
Përmbajtja e sqturit / Sulphur content	EN ISO 20045	-	10.0	mg/kg	7.9
Pika e ndezjes / Flash point	EN ISO 2719	55	-	°C	57.0
Përmbajtja e ujit / Water content	EN ISO 12937	-	200	mg/kg	89.0
Përmbajtja e esterit metilik të acidit yndyror (EMAY) / Fatty acid methyl ester (FAME)	EN 14078	-	7.0	% (v/v)	0.00
Lubrificueshmëria (wsd 1,4) në 60 °C / Lubricity (wsd 1,4) at 60 °C	EN ISO 12158-1	-	400	mm	410
Pika e distillimit 95 % (v/v) / Distillation point 95 % (v/v)	EN ISO 3465	-	-	-	360.0
Pika e filtrabilitetit për periudhën kohore gjatë vitit / Filtrability point for the time period during the year	EN 116	-	-	-	0
Nga / From 18.04. deri / to 30.09.					

**KONFORM**  
ME DISPOZITAT RREGULLATIVE  
**CONFORMITY**  
TO REGULATORY PROVISIONS

- Me datën 03 tetor 2015, çmimi i naftës me pakicë në pikat furnizuese të HIB ka kushtuar 0.990 Euro për Litër, në ndërkohë që çmimi i publikuar nga AQP me datën 01 tetor 2015 është 0.9422 Euro/Litër, për afërsisht rreth 0.0478 më i lirë se tregu me pakicë;
- Me datën 11 dhe 30 tetor 2015, çmimi i naftës me pakicë në pikat furnizuese të HIB ka kushtuar 0.980 Euro për Litër, në ndërkohë që çmimi i publikuar nga AQP me datën 02 nëntor 2015 është 0.9251 Euro/Litër, për afërsisht rreth 0.0549 më i lirë se tregu me pakicë;

Tabela e më poshtme ilustron çmimet për njësi që janë paguar nga dy autoritetet kontraktuese të përfshira në këtë kontratë.

Tabela në vijim pasqyron një krahasim të çmimeve për njësi, për muajt gusht, shtator dhe tetor 2015, për katër (4) Institucione të ndryshme publike, duke përfshirë edhe AQP.



**TABELA 10.0** Pasqyrim i çmimeve për njësi të paguara nga Autoritetet Kontraktuese

Përshkrimi	Administrata Tatimore e Kosovës			Prokurori i Shtetit		
	Gusht 2015	Shtator 2015	Tetor 2015	Gusht 2015	Shtator 2015	Tetor 2015
DIESEL 10 ppm AUTOMOBILE	0.9267	0.9422	0.9251	0.9267	0.9422	0.9251
DIESEL 10ppm GENERATOR	0.9197	0	0.9179	0	0	0
DIESEL 10ppm HEATING	0	0	0.9179	0	0	0
GASOLINE 10ppm	0.9396	0.9257	0.9112	0.9396	0.9257	0.9112
AUTOMOBILE 95,98						

|||||

|||||



**TABELA 11.0** Krahasimi i çmimeve për njësi ndërmjet Institucioneve Publike

Furnizim me Karburante	Autoriteti Kontraktues:	AQP (AQP-AK-014-002-111)	Policia e Kosovës	Komuna e Prishtinës	Komuna e Gjilanit
	Operatori Ekonomik:	HIB Petrol	HIB Petrol	Petrol Company	Petrol Company
<b>Përshkrimi</b>	<i>Muaji</i>	€/ Litër	€/ Litër	€/ Litër	€/ Litër
<b>DIESEL 10 ppm AUTOMOBILE</b>	Gusht '15	0.9267	1.0060	1.0580	0.8960
	Shtator '15	0.9422	1.0226	1.0580	0.8956
	Tetor '15	<b>0.9251</b>	1.0056	1.0580	<b>1.0508</b>
<b>DIESEL 10ppm GENERATOR</b>	Gusht '15	0.9197	1.0060	1.0580	0.8960
	Shtator '15	0.935	1.0226	1.0580	0.8956
	Tetor '15	0.9179	1.0056	1.0580	1.0508
<b>DIESEL 10ppm HEATING</b>	Gusht '15	0.9197	1.0060	1.0580	0.0000
	Shtator '15	0.9350	1.0226	1.0580	0.0000
	Tetor '15	0.9179	1.0056	1.0580	0.9098
<b>GASOLINE 10ppm AUTOMOBILE 95,98</b>	Gusht '15	0.9396	1.0143	1.0580	0.8803
	Shtator '15	0.9257	1.0015	1.0580	0.8886
	Tetor '15	<b>0.9112</b>	0.9870	1.0580	<b>1.0388</b>
Lloji I kontratës/baza e çmimit		Premium/Litër	Premium/Litër	Fikse	Premium/Litër

|||||

Nga tabela e mësipërme vërejmë se nga kontratat e Autoriteteve Kontraktuese të shfrytëzuara për këtë krahasim, vetëm komuna e Gjilanit ka paguar çmim më të ulët se AQP për muajin gusht dhe shtator 2015. Mirëpo, edhe pse me Premium 0.0001 €/Litër, Komuna e Gjilanit ka paguar çmimin për Litër për Naftë për vetura në vlerën prej 1.0508 Euro<sup>36</sup>, respektivisht 0.1257€/Litër më shtrenjtë se Autoriteti Kontraktues “ATK”, që është pjesë e kontratës AQP-AK-014-002-111, (Premium 0.0260€/Litër) dhe ka paguar 0.9251 Euro/Litër për të njëjtin muaj<sup>37</sup>. E njëjta situatë paraqitet edhe tek furnizimet me Benzinë për muajin tetor 2015, ku Komuna e Gjilanit ka paguar 1.0388/Litër (Premium 0.0001 €/Litër), respektivisht 0.1276 €/Litër më shtrenjtë se Autoriteti Kontraktues “ATK” që ka paguar 0.9112 €/Litër (premiumi 0.0159€/Litër).

Në vijim, kemi vërejtur se edhe pse furnitori është i njëjtë si për kontratën AQP-AK-014-002-111 po ashtu edhe për Policinë e Kosovës, dhe politikat e përpilimit të çmimit janë të njëjta ndërmjet dy kontratave, çmimet e AQP janë më të lira për arsye se Premiumet për litër të kontratës së AQP janë më të ulëta se ato të Policisë së Kosovës si në vijim:

Një tjetër krahasim është bërë me kontratën e Komunës së Prishtinës, e cila ka lidhur një kontratë të tjetër lloji me çmime fikse, me aktivizim të mini-konkurrencës në ndryshim të çmimeve të tregut. Përderisa në raportin e bërë nga KDI për tenderët e komunave, është vërejtur se Komuna e Prishtinës kishte siguruar çmime më të mira se AQP. Në krahasimet për muajt gusht, shtator dhe tetor 2015 vërehet se si rrjedhojë e uljes së çmimeve të derivateve në tregun ndërkombëtarë, gjatë këtyre muajve AQP ka siguruar çmime shumë më të favorshme se Komuna e Prishtinës.

36 Fatura nga Petrol Company Nr. 2301/14, data 30.11.2014

37 Fatura e HIB Petrol për ATK, Nr. FDT15-8-003814, data 31/10/2015.

Edhe pse me Premium 0.0001 €/Litër, Komuna e Gjilanit për muajin tetor 2015 ka paguar çmimin 1.0508 Euro/Litër Naftë për vetura, që është 0.1257€/Litër më shtrenjtë se Autoriteti Kontraktues “ATK”, që është pjesë e kontratës AQP-AK-014-002-111 me premium 0.0260€/Litër që ka paguar 0.9251 €/Litër.

Nafta nuk ka çmime fikse, çmimet varen nga tregjet ndërkombëtare dhe ndryshojnë shpeshherë në baza ditore

Gjithashtu, sipas dokumenteve të pranuar nga Komuna e Prishtinës, si rrjedhojë e ndryshimeve në treg të derivateve, kur çmimet ishin shumë të larta në treg, ky institucion kishte aktivizuar mini-konkurrencën, ku si përgjigje me datën 13 korrik 2015 ishte nënshkruar kontrata Nr. 616 14 059 111 me Petrol Company, me çmimet prej 1.058 €/Litër, që ishte çmimi më i ulët i pranuar nga dy kontraktorët

**TABELA 12.0** Krahasimi i çmimeve për njësi ndërmjet AQP dhe Policisë së Kosovës

Përshkrimi	Njësia	AQP	Policia e Kosovës	Diferenca
		Çmimi €/ Njësi	Çmimi €/ Njësi	
DIESEL 10 ppm AUTOMOBILE	Litër	0.0260	0.0940	-0.0680
DIESEL 10ppm GENERATOR	Litër	0.0199	0.0940	-0.0741
DIESEL 10ppm HEATING	Litër	0.0199	0.0940	-0.0741
GASOLINE 10ppm AUTOMOBILE 95,98	Litër	0.0159	0.0800	-0.0641



e përfshirë në kontratën me mini-konkurrence. Megjithatë, duke iu referuar Tabelës 11.0, vërejmë se menjëherë në muajin gusht 2015, çmimet e derivateve janë ulur, mirëpo Komuna e Prishtinës nuk e ka aktivizuar mini-konkurrencën dhe si pasojë, komuna po paguan çmimet më të larta nga këto institucione, si dhe më të lartë se çmimet në tregun me pakicë. Nga krahasimet e më sipërme mund të vërejmë se AQP ka siguruar çmime të volitshme krahas Autoriteteve Kontraktuese tjera, si dhe ndaj tregut me pakicë.

Sipas kontratës AQP-AK-014-002-111, faturat duhet të paguhën brenda jo me shume se 30 ditësh kalendarike nga data kur kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jete data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagese nuk do të jete e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose me shume nga kërkesat thelbësore.

Nga komunikimi me Operatorin Ekonomik HIB Petrol, u theksua se në përgjithësi Autoritetet Kontraktuese të përfshira në këtë kontratë janë të përgjegjshme në përmbushjen e detyrimeve financiare, me përjashtim të Komunave të cilat, jo vetëm në këtë kontratë, vazhdojnë të jenë më problematike në realizimin e pagesave.<sup>38</sup>

Kjo kontratë është ende valide, deri më datën 14 shtator 2017, andaj nuk kemi një vlerësim përfundimtar të performancës së kontratës. Gjithashtu kjo kontratë nuk është audituar nga auditori i përgjithshëm.

Komuna e Prishtinës paguan çmimin fiks prej 1.058 €/Litër edhe pse çmimi i naftës në treg me pakicë për këtë periudhë ka qenë mesatarisht 0.96 €/Litër.

<sup>38</sup> Intervistë telefonike me Fatbardh Xhaferin, HIB Petrol, me datën 09 dhjetor 2015





# KONKLUZION

- **Prokurimi i centralizuar:** ka lindur si nevojë e përmirësimit të gjendjes aktuale në prokurimin publik, ku janë identifikuar mangësi të ndryshme si dispozitat ligjore të pamjaftueshme, mungesa e trajnimeve adekuate, planifikimet e dobëta, mungesa e vullnetit të mirë dhe integritetit, mungesa e transparencës dhe llogaridhënies, mundësitë për keqpërdorime, keq menaxhimet, mos arritja e vlerës për paranë, etj.
- **Pjesëmarrja në kontratë të centralizuar:** Kontrata AQP-AK-014-002-111 ka qenë me pjesëmarrje vullnetare, ku 37 Autoritete Kontraktuese kanë shfaqur gatishmërinë për të hyrë në një marrëdhënie të centralizuar të prokurimit për karburante.
- **Prokurimi i centralizuar krijon kushte jo të favorshme për bizneset e vogla dhe të mesme:** Për shkak të dispozitave ligjore dhe garancive për sigurimin e shërbimeve të vazhdueshme për Autoritetet Kontraktuese, ky lloj i kontratës ka krijuar pozicion jo të favorshëm për bizneset e vogla dhe të mesme. Disa nga këto kritere janë kërkesat për qarkullim vjetor, garancia bankare, rezervat e derivateve në rast të krizave.
- **Prokurimi i centralizuar krijon kushte më të favorshme për menaxhimin e kontratës:** Ky lloj i kontratave eliminon llojllojshmërinë e kushteve dhe termave të përfshira në kontrata të ndryshme, te cilat mund të paraqesin predispozita jo të favorshme si për Operatorët Ekonomik, po ashtu edhe për Autoritetet Kontraktuese.
- **Prokurimi i centralizuar siguron vlerë më të mirë për paranë:** Nga analizat e çmimeve të paguara nga institucione të ndryshme, madje edhe me të njëjtin Operator Ekonomik, mund të konkludojmë se AQP ka siguruar një vlerë mjaft të mirë për paranë, në krahasim me Institucionet tjera dhe atë që është qëllimi primar, paguan çmimet më të ulëta se në tregun e pakicës.



# REKOMANDIME

## REKOMANDIMET PËR INSTITUCIONET RREGULLATIVE

Duke u nisur nga pikëpamja ekonomike që bizneset janë një nga faktorët kryesor që ndikojnë dhe kontribuojnë në zhvillimin ekonomik të një vendi, Institucionet e Kosovës duhet të angazhohen sa më shumë në mbrojtjen dhe zhvillimin e NVM-ve, duke pasur parasysh se rritja e NVM-ve ndihmon në gjenerimin e vendeve të reja të punës, stimulon ngritjen dhe rritjen e kapaciteteve, si dhe kontribuon në rritjen e buxhetit shtetëror përmes aplikimit të taksave.

Kontrata publike për një NVM nënkupton një stabilitet të ardhurash për një interval të caktuar kohorë, dhe luajnë një rol të madh në mirëqenien dhe zhvillimin e tyre.

Qeveritë e ndryshme kanë identifikuar sfidat me të cilat ballafaqohen NVM-të sa i përket qasjes në prokurim publik, sidomos për shkak të kriterëve të larta të specifikave teknike dhe kushteve të kontratave, e veçmas duke u bazuar në parimet kyçe të BE që janë Transparenca, Proporcionaliteti, Jo-Diskriminimi dhe Trajtimi i barabartë, dhe kanë aplikuar metoda të ndryshme për të adresuar këtë problem.

KDI rekomandon tek institucionet vendore rregullative që të adaptojnë udhëzimet dhe rekomandimet e BE për stimulimin e NVM-ve (The Small Business Act for Europe) dhe rritjen e pjesëmarrjes së tyre në proceset e prokurimit publik (European Union 2008b), sidomos në ndarjen e kontratave në lloje të vogla, vlerësimin e ofertave në bazën e vlerës më të mirë për paranë e jo çmimin më të ulët, zvogëlimin e kërkesave administrative dhe sasinë e dokumenteve të kërkuara.

## REKOMANDIMET PËR INSTITUCIONIN KONTRAKTUES

- KDI rekomandon që nuk duhet të paracaktohet si fikse një tarifë që do të duhej të ishte variabël (si çmimi i rafinerisë së naftës dhe transportit për litër), që në mënyrë indirekte do të favorizonin një subjekt të caktuar afarist që shfrytëzohet si pikë furnizimi me derivate.
- KDI rekomandon që si politikë e menaxhimit të mirë dhe kursimit të parasë publike, AQP të zhvilloj aktivitet e prokurimit për artikujt e përbashkët për të gjitha institucionet e Kosovës, si një praktikë e obligueshme dhe jo në baza vullnetare.
- Rekomandojmë emërtimin e një autoriteti qendror, i cili do të ishte përgjegjës për monitorimin periodik të kualitetit të derivateve
- Rekomandojmë shqyrtimin sa më të detajuar të çmimeve jo-normalisht të ulëta, meqë ato nuk pasqyrojnë një sinqeritet afarist.





KDI është Organizatë Joqeveritare (OJQ) e angazhuar të mbështesë zhvillimin e demokracisë përmes përfshirjes së qytetarëve në bërjen e politikave publike dhe fuqizimin e sektorit të shoqërisë civile me synimin për të ndikuar në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies nga ana e institucioneve publike.

Për më shumë informata rreth KDI ju lutem vizitoni [www.kdi-kosova.org](http://www.kdi-kosova.org)

Me përkrahjen financiare të:



British Embassy  
Pristina

